



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Viti II, Nr. 8

Janar & Shkurt 2005

Komunat e Kosovës kanë përmbushur shumicën e standardeve për Kosovën që janë në kompetenca të tyre

Kryeshefat e Komunave të Kosovës zotohen në emërimin e koordinatorit komunalë për të drejta e fëmijëve

Para përfaqësuesve komunal u prezentua Ligji për Ujëra dhe Draft-Ligji për Mbeturina

Involvimi i komunave në procesin e hartimit të ligjeve ndikon në implementimin e tyre

Filluan punën Komisionet e AKK-së

AKK-ja DHE KOLEGJI I KRYESHEFAVE EKZEKUTIV KËRKOJNË:

Pagat e kryeshefave ekzekutiv të jenë në nivel me ato të sekretarëve permanent të ministrive

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumi i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës i kanë dërguar një kërkesë institucionale qendrore të Kosovës në lidhje me pagat e kryeshefave ekzekutiv të komunave të Kosovës. Kërkesa është nënshkruar nga ud.kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri dhe kryetari i Kolegjiumit të Kryeshefave Ekzekutiv z.Mustafë Pllana.



NGA TAKIMI I KOORDINATORËVE KOMUNALË PËR STANDARDE PËR PËRPILIMIN E STRATEGJISË PËR KTHIMIN - 2005

Standardet janë nevojë për qytetarët e Kosovës e nuk duhet të kuptohen si kusht për statusin final

Përfaqësues të Komunave të Regjionit të Kronenbergut në Suedi kanë vizituar AKK-në

Përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Suedisë nga Regjioni i Kronenbergut kanë vizituar stafin e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Delegacionin nga Suedia, z.Harald Fredrikson, znj.Eva Schomer dhe z.Harald Niklasson që e shoqëronin edhe znj.Cyme Mahmutaj – përfaqësuese e Zyrës për barazi gjinore pranë kryeministrit dhe znj.Belgjyzare Muharremi koordinatorë e OJQ-së “Dera e hapur” e kanë pritur z.Sazan Ibrahim drejtor ekzekutiv i përcaktuar dhe z.Arsim Osmani menaxher për komunikim. Në këtë takim sa njihës aq edhe shkëmbyes të përvojave në



fushën e organizimit të komunave në nivel regjioni e vendi, është biseduar konkretisht edhe për mundësinë e vizitave në Suedi të stafit të AKK-së për të mësuar nga përvojat e tyre. Po ashtu është biseduar edhe për mundësin e

realizimit të disa projekteve kryesisht nga aspekti i barazisë gjinore të Regjionit të Kronenbergut me komunat e Regjionit të Prizrenit. Për këtë është zhvilluar edhe një takim në komunën e Prizrenit me përfaqësuesve të komunave të Prizrenit, Malishevës, Dragashit, Rahovecit dhe Therandës dhe përfaqësuesve nga Suedia. Vlen të ceket se këtyre vizitave dhe këtij bashkëpunimi u ka paraprirë një takim i vitit të kaluar nga Kosova në Suedi kur merrnin pjesë edhe z.Fehmi Mujota ish-kryetar i komunës së Shtimes dhe z.Shaban Halimi ish-kryeshef ekzekutiv i komunës së Dragashit.

Kryeshefat e Komunave të Kosovës zotohen në emërimin e koordinatorit komunal për të drejta e fëmijëve

Forumi për të Drejtat e Fëmijëve dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë mbajtur një takim të përbashkët me Kryeshefat e Ekzekutivit të Komunave të Kosovës për të debatuar lidhur me mundësinë e emërimit të koordinatorëve komunalë për të drejtat e fëmijëve.



"Çdo shoqëri shpreson dhe pret që fëmijët, kur të mriten, të jenë qytetarë të aftë dhe të përgjegjshëm që do të kontribuojnë për mirëqenien e komuniteteve të veta" - tha në hapje të takimit **z. Ismet Beqiri** u.d.kryetarit të AKK-së i cili shtoi se "megjithatë, shumë fëmijëve në mbarë botën u shkelen të drejtat, pa të cilat ata nuk mund të zhvillohen e të formësohen plotësisht e as të jenë pjesë-marrës aktiv të shoqërisë. Nuk mund të presim që ata fëmijë të cilëve u mohohen nevojat dhe të drejtat themelore, të shndërrohen në qytetarë të mritur që janë produktivë dhe që i respektojnë të drejtat e të tjerëve. Shkelja e të drejtave nuk është vetëm burim i vuajtjeve personale; ajo po ashtu i mbjell farat e problemeve të ardhshme politike dhe shoqërore, madje dhe të konflikteve të dhunshme". **Znj. Katherine Mahoney** - drejtoreshë e organizatës "Save the Children" dhe përfaqësuese e Forumit për të Drejtat e Fëmijëve tha se "Forumit për të drejtat e fëmijëve të Kosovës është një grup i 15 organizatave joqeveritare. Forumi është themeluar në Shtator të vitit 2002". Në vazhdim **znj. Mahoney** tha se "standardet kërkojnë fokus në të mach për të drejtat e njeriut por disa të drejtat e fëmijëve shumë shpesh anashkalohe në diskutime edhe pse ata përbëjnë 43% të popullsisë së Kosovës. Ne nuk mundemi të flasim për të drejtat e njeriut pa i adresuar të drejtat e fëmijëve". Sa i përket të drejtave të fëmijëve sot në Kosovë **znj. Mahoney** shtoi se "jo të gjithë fëmijët e realizojnë të drejtën për edukim; 10% të vajzave e braktisin shkollën pa e mbaruar klasën e pestë; 30% të

Konkluzionet

1. Komunitat janë të pavarura që të vendosin për pozitën e zyrtarit për të drejtat e fëmijëve si pozitë të plotë apo si detyrë shtesë. Gjithashtu komunitat inkurajohen që nëse ekziston mundësia të emërojnë zyrtarin për të drejtat e fëmijëve si pozitë të plotë.
2. Komunave u sugjerohet që ky zyrtarë do të jetë ndihmë për gjithë komunën, që të bashkëpunoj me të gjitha departamentet e tjera (Bëhëmi, Shëndësi, Kulturë, Rini, Mirëqenia Sociale) dhe t'i raportoj direkt Kryeshefit të Ekzekutivit.
3. Për shkak të ndihmës teknike dhe organizative që planifikohet tu jepet këtyre zyrtarëve pas një afati të shkurtër kohor, ju lutemi që mundësisht brenda një kohe të shkurtër (prej 10 ditësh), emrat e zyrtarëve komunal për të drejtat e fëmijëve të dërgohen në AKK-së.
4. Zyrtarëve komunal për të drejtat e fëmijëve dhe organet komunale të vazhdojnë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në komunitat e Kosovës.

vajzave e braktisin shkollën pa e mbaruar klasën e nëntë; 60% të minoriteteve jo serbe e braktisin shkollën pa e mbaruar shkollën e mesme". Përfaqësuesi i Ministrisë së Pushtetit Lokal **z. Vilhard Shala** tha se "Ministria e pushtetit lokal do të përkrahë çdo iniciativë që vjen nga ana e komunave të Kosovës për fuqizimin e pozitës së koordinatorëve komunal për të drejtat e fëmijëve.

Kryetari i Kamenicës **z. Shaip Surdilli** tha se "duhet të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë nga ana e komunave për të emëruar koordinatorin për të drejtat e fëmijëve me pozitë të plotë". Kryeshefi i Pejës **z. Ramiz Zeka** tha se "Komuna e Pejës e ka zgjidhur çështjen e koordinatorit dhe në Qershor të vitit 2004 ka pranuar me pozitë të plotë koordinatorin për të drejtat e fëmijëve". Kryetari i AKK-së **z. Ismet Beqiri** propozoi që "derisa të zgjidhet statusi si pozitë e plotë e koordinatorit komunal për të drejtat e fëmijëve të caktohet një punëtor civil i komunës si detyrë shtesë, për shembull, në komunën e Prishtinës kjo detyrë i është dhënë zyrtares për rini". Kryeshefi i Shtimës **z. Naim Ismajli** tha se "Komuna duhet të angazhohet për emërimin e koordinatorit për të drejtat e fëmijëve por për momentin në komunën tonë nuk ekziston mundësia për post të veçantë por vetëm si detyrë shtesë të punëtorit civil të komunës, pasi që komuna është para shumë kërkesave për koordinatorë për standarde, për çështje gjimore etj. Po ashtu në komunat e vogla zyrtarët civil duhet ti kryejnë 2-3 detyra". Kryeshefi i Istogut **z. Haki Rugova** tha se "nuk duhet të diskutohet se a duhet të emërohet koordinatori për të drejtat e fëmijëve në pozitë të plotë, çdo kryeshef duhet ta gjejë mënyrën që ta emërojë koordinatorin në pozitë të plotë".

Filluan punën Komisionet e AKK-së

Në Konferencën e AKK-së në nëntor 2004 është miratuar projekti që të krijohen komisionet e saja për të ndihmuar komunitet me analizimin e çështjeve të qeverisë lokale dhe t'ia paraqesin ato Qeverisë.

Këshilli i Asociacionit ka emëruar si anëtarë të komisioneve kryetarët e komunave dhe anëtarë të ish-Grupeve Analizuese Komunale, ndërkohë që edhe Kolegji i Kryeshefave Ekzekutivë ka shtuar anëtarët e vet në këto Komisione.

Komisionet që kanë mbajtur takimet e para, të cilat janë bazuar kryesisht në rekomandimet e Deklaratave Parimore që kanë dal si rezultat i punës së grupeve analizuese. Komisioni për Shërbime Publike më 25 janar 2005, Komisioni për Financa Lokale më 27 janar 2005, Komisioni për Regjistrim të Biznesit dhe Licencim më 1 shkurt 2005, Komisioni për Arsimit më 2 shkurt 2005, Komisioni për

Reformë Administrative dhe Pjesëmarrje Qytetare më 3 shkurt 2005, Komisioni për Planifikim Urban dhe Rural dhe Vende Publike më 8 shkurt 2005, Komisioni për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Turizëm më 9 shkurt 2005, Komisioni për Pronë 14 shkurt 2005, Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sport 15 shkurt 2005, Komisioni për Menaxhim të Burimeve Njerëzore dhe Çështjet Gjimore 16 shkurt 2005 dhe Komisioni për Kujdes Parësor Shëndetësor dhe Banim Social 17 shkurt 2005. Vlen të përmendet se në takimin e parë të Komisionit për Shërbime Publike që është mbajtur më 25 janar 2005 ku ishin prezent edhe zyrtar nga MMPH, si kërkesë për veprime të mëtejshme ka qenë edhe organizimi i një debati të hapur nga MMPH lidhur me ligjin e ujërave si dhe draft ligjit mbi mbeturinat me të gjitha Komunitat e Kosovës në nivel të Kryetarëve, Kryeshefave Ekzekutiv dhe të drej-

torive përkatëse që kanë të bëjnë me Shërbime Publike dhe ky takim i prezantimit të ligjit mbi ujërat dhe draft ligjit mbi mbeturinat u mbajt më 11 shkurt 2005 me përfaqësuesit e komunave. Ndërsa në takimin e parë të Komisionit për Financa Lokale është ngritur çështja e gjobave në trafik. Komunitat janë ankuar se nuk ka kurrfarë transparence lidhur me të hyrat nga gjobat mandatare në trafik. Ndërsa për gjobat në trafik që paguhet përmes gjykatave, bazuar në urdhëresën administrative 2001/9 Komunitat kërkojnë t'u derdhen në buxhet gjë kjo që nuk ka ndodhur asnjëherë pas lufte. Si kërkesë për veprime të mëtejshme ka qenë që në takimin e dytë të këtij Komisioni të ftohen zyrtari nga Departamenti i Administratës Gjyqësore, Departamenti për Buxhet dhe Financa të SHPK-së dhe MEF. Në takimin e dytë të komisionit që u mbajt më 24 shkurt 2005 u arrit një marrëveshje që të organizohet një takim në mes pesë anëtarëve të Komisionit për financa lokale me ministrin Haki Shatri dhe Drejtorin e Buxhetit të Kosovës.



AKK-ja DHE KOLEGJI I KRYESHEFAVE EKZEKUTIV KËRKOJNË:

Pagat e kryeshefave ekzekutiv të jenë në nivel me ato të sekretarëve permanent të ministrive

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumi i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës i kanë dërguar një kërkesë institucioneve qendrore të Kosovës në lidhje me pagat e kryeshefave ekzekutiv të komunave të Kosovës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumi i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës i kanë dërguar një kërkesë institucioneve qendrore të Kosovës në lidhje me pagat e kryeshefave ekzekutiv të komunave të Kosovës. Në takimin e Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës të datës së 09 Shkurt-it 2005 u diskutua edhe njëra ndër çështjet e cila po i preokupon Kryeshefat Ekzekutiv të Komunave të Kosovës, çështja e të ardhurat personale.

Duke qenë dëshmitar se paga e deritashme e Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës kanë qenë nën nivelin e obligimeve dhe përgjegjësi që janë të ngarkuar si udhëheqës të administratës së Kuvendeve Komunale të Kosovës, se pagat e kryeshefave ekzekutiv janë në nivel të njëjtë me drejtorët e departamenteve, kërkojmë që paga e Kryeshefit Ekzekutiv të Komunave të Kosovës të jetë në nivelin e pagës së Sekretarit Permanent të Ministrive të Qeverisë së Kosovës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumi i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës kërkojnë që paga e kryeshefave ekzekutiv në nivel të Sekretarëve Permanent të Ministrive dhe të paguhet retoraktivisht nga data 1 janar 2005.



Ismet Beqiri



Mustafë Pllana

Kjo kërkesë që është nënshkruar nga z.Ismet Beqiri ud.kryetarit të AKK-së dhe z.Mustafë Pllana - Kryetar i Kolegjiumit të Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës i është dërguar z.Ramush Haradinaj - Kryeministër i Kosovës, znj.Melihate Tremkollli - Ministre e Shërbimeve Publike, z.Haki Shatri - Ministër i Ekonomisë dhe Financave, z.Lutfi Haziri - Ministër i Pushtetit Lokal.

NGA TAKIMI I KOORDINATORËVE KOMUNALË PËR STANDARDE PËR PËRPILIMIN E STRATEGJISË PËR KTHIMIN - 2005

Standardet janë nevojë për qytetarët e Kosovës e nuk duhet të kuptohen si kusht për statusin final

Koordinatorët Komunalë për Standarde në takimin që kanë mbajtur sot në lokalet e AKK-së kanë diskutuar për përvojat e komunave në hartimin e Strategjisë Komunale për Kthim - 2005.

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Ismet Beqiri në hapje të takimit tha se "tash po hyjmë në një fazë pune të ngjeshur edhe për përmbushjen e standardeve për Kosovë, të cilët janë në përgjegjësi të pushtetit lokal në Kosovë dhe standardet janë nevojë për qytetarët e Kosovës, por ato nuk mund të kuptohen si kusht për statusin final". Kryetari Beqiri shtoi se "jo çdo gjë varet nga komunat e Kosovës, derisa ne do të plotësojmë dhe përmbushim me sukses ato standarde që janë në përgjegjësi të tona e në këtë rast do të angazhohemi që të krijojmë parakushte për kthimin dhe integrimin e qëndrueshëm. Kthimi nuk ka të bëjë vetëm me serbët por për të gjithë".

Duke folur rreth hartimit të strategjive komunale për kthimin në vitin 2005, kryetari Beqiri tha se duhet të shkëmbejmë përvojat në mënyrë që ato komuna që kanë ngecur në këtë drejtim të kenë më të lehtë përpilimin e strategjive". Koordinatorët komunale për standarde kanë pasqyruar punën e tyre në hartimin e strategjive komunale për kthim dhe integrim. Këto janë çështje praktike, për të cilat asociacioni do të bashkëpunojë në mënyrë të ngushtë me qeverinë për t'i zbatuar në praktikë standardet,



vlerësuan zyrtarët komunal për kthimin, të cilët në takimin e së enjtes plotësuan pyetsorët, në bazë të të cilëve do të bëhet vlerësimi i deritashëm i punës nëpër komuna. Poashtu koordinatorët komunal u pajtuan gjithashtu për një bashkëpunim të ndërsjellë në kryerjen obligimeve dhe në realizimin me sukses të detyrave të parashtruara në përmbushjen e standardeve.

Komunat e Kosovës kanë përbushur shumicën e standardeve për Kosovën që janë në kompetenca të tyre

Asociacioni i Komunave të Kosovës në mbështetjen financiare të KFOS-it ka organizuar Konferencën dyditore në Ohër me 28 e 29 janar me kryetarët dhe kryeshefat ekzekutiv të komunave lidhur me arritjet e komunave në përbushjen Standardeve për Kosovën, me theks në Standardin e III-të (Liria e Lëvizjes) dhe Standardin e IV-të (Kthimi dhe Riintegrimi) e ku morën pjesë 12 kryetarë të komunave, 6 zv.kryetar, 15 kryeshefa ekzekutiv, 1 zv. kryeshef dhe 3 përfaqësues tërë komunale, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal (zv.ministri z.Aziz Lila dhe këshilltari i ministrit Haziri, z.Naim Behluli) dhe përfaqësuesit e AKK-së. Konferencën me kryetarët dhe kryeshefat ekzekutiv të komunave të Kosovës lidhur me arritjet e komunave të Kosovës në përbushjen Standardeve për Kosovën, me theks në Standardin e III-të (Liria e Lëvizjes) dhe Standardin e IV-të (Kthimi dhe Riintegrimi) e ka hapur drejtori ekzekutiv i përcaktuar në AKK z.Sazan Ibrahim i cili ndër të tjera theksoi se "ky takim është na radhën e takimeve që ka organizuar AKK-ja në lidhje me vlerësimin për përbushjen e planit Standardet për Kosovën nga këndi i përgjegjësisë të Komunave të Kosovës". z.Aziz Lila - zv. në Ministrinë e Pushtetit Lokal tha se MPL-ja edhe pse është ministri e sapoformuar ka ngritur një bashkëpunim të mirë me komunat e Kosovës kryesisht në lidhje me implementimin për përbushjen e planit të Standardeve për Kosovën". Kryetari i Obiliqit z.Ismet Hashani tha se "për të përbushur disa standarde komunat duhet të mbështeten me buxhet nga qeveria qendrore. Kryeshefi i Prizrenit z.Ragip Gajraku në fjalën e tij tha se "janë disa gjëra që po politizohen në ekstrem si çështja e procedurave të rregullta ligjore. Mos po fusim dozë politike në procesin e ndërtimit të shtetit normal ligjor në Kosovë". Kryetari i Vushtrrisë z.Muharem Shabani tha se "këto standarde kanë edhe primesa juridike e politike. Sa i përket kthimit unë dua të theksoj se ne si komunë kemi

takime me qytetarët e të gjitha komuniteteve dhe serbët thonë se nuk guxojnë me pranuar asgjë jashtë atyre që vijnë nga jashtë Kosovës". Kryetari i Gjilanit z.Xhemajl Hyseni tha se "ne kemi ardhë këtu me pa se ku kemi arritur me realizimin e standardeve dhe filluam me vërejtje ndaj Qeverisë e AKK-së". Kryeshefi i Shtimës z.Naim Ismajli tha se "duhet të ndërrojmë formën e komunikimit mes komunave e institucioneve qendrore". Kryetari i Pejës z.Ali Lajçi tha se "problemet që kemi ne komunat kanë dallime, ne në Pejë kemi edhe 3500 shtëpi të djegur e në anën tjetër kërkohet përbushja e standardeve, por ne duhet ti plotësojmë standardet por jo me e tepruar normat. Kryetari i z.Aqif Shehu tha se "ne kemi ardhë me diskutuar për përbushjen e standardeve dhe ato i kemi të afatizuara". Sesionin "Ku janë komunat në përbushjen e standardeve" e ka udhëhequr kryetari i Kamenicës z.Shaip Surdulli i cili tha se "nuk është hera e parë që komunat bisedojnë për standardet. Duhet të fillojmë nga ajo që çka kemi bërë deri tani dhe ku jemi për realizimin e përbushjes dhe fillimi i bisedave për statusin". Kryetarët dhe kryeshefat ekzekutiv të Komunave (z.Hajriz Bekteshi z.Mustafë Pllana z.Ramë Manaj z.Fadil Ferati z.Nahit Elshani z.Aqif Shehu z.Faik z.Mazllum Qafani z.Xhemajl Hyseni etj.) kanë raportuar në hollësi për të arriturat nëpër komuna lidhur me përbushjen e standardeve në lirinë e lëvizjes dhe kthimin dhe riintegrimin. Sesionin "Problemet dhe vështirësitë në përbushjen e standardeve" e ka udhëhequr Kryeshefi i Prizrenit z.Ragip Gajraku i cili tha se "Komuna e Prizrenit është një Kosovë miniaturë ku bashkëjetojnë disa komunitete me kultura e gjuhë të ndryshme. Një pjesë e madhe e standardeve janë plotësuar". Koordinatorin për Standarde të komunës së Gjakovës z.Zef Komoni tha se "Liria e Lëvizjes në komunën tonë është implementuar për aq sa kemi kompetenca". Kryetari i Pejës z.Ali Lajçi kërkoi nga bashkëbiseduesit që "të bisedojmë për anën administrave e

jo teknike". Zv.kryetari i Mitrovicës z.Mustafë Ibrahim tha se "ne jemi komunë me administratë të Kuvendit Komunal dhe me administratë të UNMIK-ut e që në pjesën veriore ne nuk kemi qasje". Kryetari i Obiliqit z.Ismet Hashani tha se "sigurinë e qytetarëve e ka në përgjegjësi KFOS-i. Serbët në komunën tonë lëvizin lirshëm". Kryeshefi i Shtimës z.Naim Ismajli shtoi se "komunat në përgjithësi i kanë përbushur standardet, shihet se secila komunë e ka grupin për kthim, kanë bërë apelet për kthim dhe riintegrim, në proces është zgjedhja e zyrtarëve për kthime, asnjë ekces nga ngjarjet e marsit". Kryeshefi i Dragashit z.Bexhet Xheladini tha se "në komunën tonë nuk ka probleme me lirinë e lëvizjes dhe Përdorimi i lirë i gjuhës është në nivel, problem në përbushjen e disa standardeve është vetëm kostoja financiare". Kryeshefi i Kamenicës z. Islam Thaci tha se "komunikimi i komunave të jetë me MPL-në e jo me AKK-në". Sesionin "Si të tekalohen problemet dhe si të arrihet në përbushjen e standardeve" e ka udhëhequr kryetari i Vushtrrisë z.Muharem Shabani i cili në fillim tha se "nga diskutimet e deritanishme u pa se është bërë punë e madhe në përbushjen e standardeve. Të gjitha këto do ti përmbledhim në konkluzionet e konferencës. Kryetari i Pejës z.Ali Lajçi tha se "Mbishkrimet ti bëj komuna e Mitrovicës ndërsa vendosjen e tyre ta bëj UNMIK-u në veri. Standardet duhet të jenë në funksion të kthimit të të gjithëve dhe gjithësi kthimi të jetë integruar që ka filluar të arrihet diku-diku". Kryetari i Gjakovës z.Aqif Shehu informoi se "SHPK-ja në Gjakovë pati filluar me na sjell raportet ditore mirëpo tashmë e ka rralluar". Ndërsa kryetari i Pejës z.Ali Lajçi kërkoi që "raportet e policisë për Kuvendit Komunale të jenë vetëm për informim". Kryeshefi i Prizrenit z.Ragip Gajraku shtoi në këtë rast se "ne u kemi shkruar letër SHPK-së dhe kemi kërkuar ato informata ditore ndërsa na kanë akuzuar si tentues të marrjes së kompetencave".

(Arsim Osmani)



Kryetarët dhe kryeshefat e komunave të Kosovës debatuan në



OHËR: 28 - 29 JANAR 2005



Ohër për Standardin III dhe IV

KONKLUZIONET

1. Komunat e Kosovës janë të përkushtuara në përbushjen e plotë të të gjitha përgjegjësisë dhe detyrave që dalin nga plani për implementimin e Standardeve për Kosovën.
2. Nga diskutimet dyditore, ku komunat kanë raportuar në tërësi në mënyrë të argumentuar për nivelin e përbushjes së Standardeve për Kosovën, është konstatuar se është bërë një progress i mirë në përbushjen e standardeve që janë në përgjegjësi të komunave.
3. Me qëllim të dinamizimit e përbushjes së afateve dhe respektimit të tyre, Komunat kërkojnë përkrahje dhe ndihmë nga Institucionet Qendrore vendore e ndërkombëtare të Kosovës.
4. Komunat janë të zotuar që t'u ofrojnë trajtim e shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim etnie.
5. Komunat u bëjnë apel të gjitha komuniteteve që të integrohen në shoqërinë kosovare, gjegjësisht në institucionet komunale, e në veçanti pjesëtarëve të komunitetit serb, ku në disa komuna vërehet instrumentalizimi i tyre nga qarqe jashtë Kosovës.
6. Nga aspekti konkret i përbushjes së standardeve, në takim, Komunat kanë konstatuar se aplikohet

dygjuhësia në dokumentet zyrtare komunale.

7. Komunat shprehin gatishmëri që të ofrojnë përkthim simultant për çka kërkojnë ndihmë financiare për sigurimin e pajisjeve adekuate.
8. U konstatua se të gjitha dokumentacionet personale lëshohen në gjuhën e palës.
9. Sa i përket vendosjes së mbishkrimeve në gjuhët zyrtare, brenda dhe jashtë institucioneve komunale, ato janë në procedurë të zbatimit. Ndërsa sa i përket vendosjes së tabelave të rrugëve, shesheve e lagjeve, komunat kërkojnë përkrahje financiare.
10. Zhvillimi ekonomik lokal determinon qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e përbushjes së standardeve për të krijuar një ambient më të qetë për të gjithë qytetarët dhe mundësi për perspektivë e ardhmëri e në veçanti për punësim.
11. Komunat kërkojnë nga Institucionet Qendrore, posaqërisht nga UN-MIK-u zhbërjen e strukturave paralele me qëllim të integritimit më të shpejtë të komuniteteve.
12. Me qëllim të stabilizimit më të shpejtë të sigurisë në tërësi në Kosovë, Komunat kërkojnë që sa më shpejtë të zbardhet fati të të gjithë të zhdukurve.

Moszbardhja e fatit të të pagjeturve reflekton drejtpërdrejt dhe negativisht në përbushjen e standardeve relevante si kthimin dhe riintegrimin si dhe lirinë e lëvizjes.

13. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë në pjesën veriore të Mitrovicës në të cilën janë duke funksionuar institucionet paralele dhe i vendosur një numër i qytetarëve të komunitetit serb nga disa komuna, gjendje e cila reflekton negativisht në situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, udhëheqësit komunal angazhohen dhe apelojnë që të gjithë ata qytetarë të kthehen në komunat dhe pronat nga kanë shkuar. Poashtu udhëheqësit komunal edhe një herë kërkojnë nga Institucionet Qendrore vendore dhe ato ndërkombëtare që t'i rishqyrtojnë rregulloret dhe aktet normative të cilat pengojnë integrimin e plotë dhe shtrirjen e kompetencave në gjithë territorin e Mitrovicës.

14. Udhëheqësit komunal i ftojnë të gjithë personat e zhvendosur gjatë ngjarjeve të marsit që të kthehen në shtëpitë e renovuara nga mjetet e buxhetit të Qeverisë së Kosovës.

15. Gjatë këtij takimi u pa se të gjitha komunat kanë emëruar koordinatoren komunale për standarde si dhe zyrtarët për kthim.

Kryetarët e Komunave konfirmojnë zotimin për përmbushjen e standardeve

Prishtinë, 26 shkurt

Kryeministri i Kosovës z.Ramush Haradinaj dhe ministri i Pushtetit Lokal z.Lutfi Haziri kanë organizuar një takim me kryetarët e komunave të Kosovës për të parë se sa janë realizuar standardet e parashtruara nga bashkësia ndërkombëtare. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se "qëllimi i këtij takimi është të vërtetojmë se është arritur sukses dhe të vendosim të vazhdojmë punën me një dinamikë edhe më të madhe në plotësimin e standardeve". Për të realizuar veprimet që duhet ndërmarrë ka pengesa financiare dhe buxhet shtesë nuk do të ketë por z.Haradinaj u propozoi kryetarëve të komunave që të shfrytëzojnë fondet e dedikuara për projekte. Ministri i Pushtetit Lokal z.Lutfi Haziri pas takimit tha se "angazhimi dhe përkushtimi i kryetarëve të Komunave është që t'i implementojnë standardet ku në këtë takim u konstatua progresi dhe lëvizjet pozitive në këtë drejtim.



Zv/kryeadministratori z.Larin Rosin duke marrë pjesë në këtë takim tha se "është shumë e rëndësishme që progresi i standardeve të bëhet jo vetëm në nivelin qendror por edhe në atë lokal. Në fakt shumë standarde mund të implementohen me sukses në nivelin lokal". Ushtruesi i detyrës së kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri tha se është vërejtur një dëshmi dhe seriozitet i të

gjithëve në përmbushjen e standardeve dhe kryetarët e komunave konfirmuan zotimin se do të kryejnë obligimet që dalin nga implementimi i standardeve për Kosovës".

Në fund të takimit, Qeveria e Kosovës përmes një letre u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, që të respektojnë ligjin, të kenë mirëkuptim, tolerancë dhe respekt të ndërsjellë. Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë obligim moral e qytetarë që të kuptojnë rëndësinë e proceses nëpër të cilat po kalojmë si vend dhe si shoqëri dhe të ndihmojmë institucionet qendrore dhe lokale për implementimin e standardeve duke kultivuar ndjenjën e tolerancës, të mirkuptimit dhe të respektit për njëri-tjetrin. Letrën drejtuar qytetarëve të Kosovës e kanë nënshkruar, kryeministri Ramush Haradinaj në emër të Qeverisë së Kosovës, u.d. kryetarit të AKK-së z.Imste Beqiri dhe kryetarët e komunave prezent në këtë takim.

Stabilizimi përmes realizimit të të drejtave dhe tolerancës

Edhe në vitin 2004 Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe CARE Int. kanë vazhduar takimet e "Stabilizimi përmes realizimit të të drejtave dhe tolerancës" me udhëheqës të fshatrave dhe bashkësive lokale.

Kësaj rradhe takimi u organizua me udhëheqës të fshatrave dhe bashkësive lokalë të regjioneve të Mitrovicës dhe Pejës më datën 02 Shkurt 2005 në Hotelin "Palace" në Mitrovicë. Edhe ky takimi i stabilizimit përmes Realizimit të të Drejtave dhe Tolerancës ka pasur për qëllim t'u ndihmojë komuniteteve që ta zhvillojnë kapacitetin që në mënyrë të pavarur t'i menaxhojnë konfliktet dhe për të mundësuar dialog dhe ndërveprim konstruktiv me qëllim të krijimit të një integrimi etnik të qëndrueshëm dhe të suksesshëm. Përveç përfaqësuesve të bashkësive të komunës së Mitrovicës dhe Pejës kanë marrë pjesë edhe me diskutimet e tyre, ud.kryetarit të AKK-së z.Ismet Beqiri, kryetari i komunës së Mitrovicës Faruk Spahija, zëvendës-kryetari i Mitrovicës z.Mursel Ibrahim, kryeshefi z.Mustafë Pllana, kryetari i komunës së Gjakovës z.Aqif Shehu, kryetari i komunës së Vushtrrisë z.Muharrem Shabani, zyrtari i UNCHR-së etj.

KONKLUZIONET

Standardet

- Standardet janë rruga e Kosovës për Evropë dhe është në interes të të gjithë kosovarëve.
- Puna praktike në përmbushjen e standardeve do të jetë çështje thelbësore.

Marrëdhëniet Ndëretnike: Ballafaqimi me tensione, kapërcimi i tyre

- Komunitetet duhet të zhvillojnë kapacitetin që në mënyrë të pavarur t'i menaxhojnë konfliktet.
- Ekziston vullnet i përbashkët në përmirësimin e situatës ekzistuese.
- Shkëmbimi i përvojave të mira nga pjesë të ndryshme të Kosovës është e rëndësishme rreth përmirësimit të situatës.
- Marrëdhëniet ndër-etnike janë përmirësuar dukshëm, por janë duke u përmirësuar dita-ditës.
- Jeta dhe zhvillimet kulturore-sportive ndikojnë dukshëm në rritjen e tolerancës ndër-etnike.
- Ekziston gatishmëri e qytetarëve të Mitrovicës, veçmas e shqiptarëve të veriu të Mitrovicës për një tolerancë dhe bashkëpunim. Tolerancë kjo që ka filluar të jep rezultate. Shuarja e institucioneve paralele do të jete rezultate shumë të mëdha në integrim të të gjithëve në jetën institucionale.
- Punësimi (zhvillimi ekonomik), është një ndër kushtet ose kushti kryesor i tolerancës- mirëkuptimit ndër-etnike.



- Roli i mediave është i rëndësishëm në këtë proces, pra në krijimin e tolerancës.

Kthimi të qëndrueshme dhe të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre dhe roli i themelimit të dialogut ndëretnik në nivelin e komuniteteve

- Me procesin e KTHIMIT nënkuptohet kthimi i të gjithëve e jo vetëm kthimi i një komuniteti.
- Toleranca brenda një komuniteti është bazë për tolerancë ndër-etnike.
- Kthimi duhet të bazohet në vullnetin e personit i cili dëshiron të kthehet.
- Krijimi i kushteve për kthim është shumë i rëndësishëm për marrjen e vendimit për personin i cili dëshiron të kthehet.
- Problemi i kthimit është direkt i lidhur edhe me zhvillimin ekonomik.
- Krijimi i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është shumë i rëndësishëm për këtë proces.
- Shumica e komunave i kanë emëruar zyrtarët për kthim si dhe kanë përpiluar strategjinë komunale për kthim të qëndrueshëm.
- Roli i komunitetit " mikpritës " në procesin e kthimit është më se i nevojshëm.
- Procesi i kthimit nënkupton edhe krijimin e kushteve për kthim të të gjitha komuniteteve.
- Bashkëpunimi jo vetëm në këtë proces, por edhe në gjitha proceset tjera, pra bashkëveprimi- Asociacioni i Komunave, Ministrinë e ndryshme si dhe zyra e Kryeministrit është i domosdoshëm dhe i mirëseardhur.
- Kthimi është proces që nuk mund të afatizohet, por më rëndësi është fillimi i procesit dhe ngadalë arritja e rezultateve përkatëse.
- Eliminimi i strukturave paralele- kusht për zgjidhjen e problemit të veriu të Mitrovicës.

Para përfaqësuesve komunalë u prezantua Ligji i Ujërave dhe Draft-Ligji për Mbeturina

Në takimim e fundit të komisionit për Shërbime publike, të mbajtur me 25 janar 2005, takim në të cilin kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Departamenti i ujërave pranë MMPH-së, si kërkesë për veprime të mëtejshme ka qenë edhe organizimi i një debati të hapur nga MMPH-ja lidhur me Ligjin e ujërave dhe draft-ligjin për mbeturina me të gjithë përfaqësuesit e komunave të Kosovës.

Prezantimi i Ligjit për Ujëra

Takimin e ka hapur z. Ismet Beqiri u.d./kryetarit të AKK-së, ndërsa është kryesuar nga z. Fatmir Rashiti kryetar i komunës së Shtimes dhe kryesues i Komisionit për Shërbime Publike të AKK-së. Prezantimin e Ligjit të Ujërave të Kosovës e ka bërë z. Baton Begolli, Drejtor i Departamentit të ujërave në MMHP me asistim të z. Avdi Gjonbalaj gjithashtu nga departamenti i ujërave pranë MMPH-së, ndërsa draft Ligjin për mbeturina e ka prezantuar z. Ahmet Krasniqi, nga Departamenti i Mbrojtjes së Ambientit në MMPH i asistuar nga z. Enver Tahiri po nga i njëjti Departament. Pas prezantimit të këtij ligji nga përfaqësuesit e MMPH-së nga përfaqësuesit komunal u tha se ligji ka rëndësi për Komunitet në u tha se ligji është aprovuar pa konsultim paraprak me komunat dhe se ndikimi në ndryshim të këtij ligji sipas nevojave dhe përvojave komunale ndoshta është i vonshëm. Po ashtu çështja e pronësive së ujërave



dhe se kush do të menaxhojë me to nuk është i definuar në ligji, (komuna e Shtimes, tri sisteme, një e menaxhuar nga Kompania Rajonale Prishtina dhe dy janë pa menaxhim).

Prezantimi i Draft-Ligjit për Mbeturina

Pas prezantimit të Draft ligjit për mbeturina nga përfaqësuesit e MMPH, përkatësisht nga Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, u përshëndet nga përfaqësuesit e komunave iniciativa e MMPH-së dhe DMM-së që komunat po përfshihen në këtë fazë të hershme të draftimit të këtij ligji me qëllim të marrjes së propozimeve dhe vërejtjeve edhe nga komunat, në mënyrë që ligji të jetë më komplet.

Edhe pse vërejtjet e komunave nga përfaqësuesit e ministrisë janë kërkuar që të jenë me shkrim, të

cilat do të dërgoheshin përmes AKK-së në ministri këtu janë disa nga vërejtjet - sugjerimet e përfaqësuesve të komunave: Kështu sipas përfaqësuesve të aspekti i menaxhimit të mbeturinave të ndahet në tri grupe, në mbeturina organike, mbeturina speciale dhe mbeturina të rrezikshme. Po ashtu gjatë debatit pati edhe vërejtje si pse nuk janë përfshirë edhe mbeturinat radioaktive në ligji, licencimi i kompanive të mbeturinave, vështirësitë e aplikimit të ligjit në praktikë, për arsye të shumave të mëdha ndëshkimore në të holla, parandalimi me dënime mandator, i dënimeve pasuese më të mëdha të bëhet me akt nën-ligjor, në dhënien e dënimeve të përfshihet edhe policia përveç inspektorëve si dhe zgjerimi i kompetencave të inspektorëve. Në fund u tha se në mënyrë të përmirësimit të raporteve nivel lokal nivel qendror është parë e udhës një komunikim i tillë i cili është përshëndetur nga u.d. i kryetarit të AKK-së z. Ismet Beqiri dhe nga kryesuesi i Komisionit të AKK-së për shërbime publike z. Fatmir Rashiti duke kërkuar që edhe për ligjet e tjera që do të dalin së pari të konsultohen komunat në mënyrë që ligjet të jenë gjithëpërfshirës dhe të zbatueshëm duke marrë parasysh që komunat janë ato të cilat merren drejtpërdrejt me zbatimin e tyre derisa edhe nga përfaqësuesit e ministrisë u premtua një bashkëpunim edhe në të ardhmen.

NGA TAKIMI I DREJTORËVE TË DREJTORIVE PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM

Involvimi i komunave në procesin e hartimit të ligjeve ndikon në implementimin e tyre

Ushtuesi i detyrës së kryetarit të AKK-së z. Ismet Beqiri në hapje të takimit me drejtorët e Drejtorive të Urbanizimit dhe Planifikimit të Komunave të Kosovës tha se "ky takim është organizuar me kërkesë të Komisionit për Planifikim dhe Urbanizim të AKK-së për të diskutuar afatizimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor prej 18 muajve për komunat e Kosovës". Kryetari Beqiri shtoi se po ashtu të gjitha komunat kanë halle të njëjta në sferën e planifikimit dhe urbanizimit dhe në shumicën e rasteve kemi mungesë të kuadrove profesionale edhe në nivel qendror. Njëkohësisht z. Beqiri njoftoi drejtorët se "Drejtoritë e Urbanizimit dhe Planifikimit të Komunave shumë shpejt do të pajisen me plotera nga AKK-ja që është donacion i Agjencionit Evropian për Rindërtim". Drejtori i Drejtorisë për Planifikim e Urbanizim në komunën e Prishtinës z. Lulzim Nixha tha se "MMPH-ja ka bërë ligj që fare nuk përkon me realitetin në Kosovë dhe nuk janë pyetur fare komunat. Komunitet duhet të kenë për bazë planin zhvillimor hapësinor të Kosovës ndërsa për me u bë planet e komunave në këtë drejtim duhet me pasur ekstraktet përcjellëse dhe të bëhet plani strategjik zhvillimor i Kosovës që ende nuk e ka bërë Ministria". Pas diskutimeve të të gjithë drejtoreve, ata kanë nxjerrë këto **konkluzione**:

1. Involvmi i Komunave në procesin e hartimit të ligjeve është i patjetërsueshëm. Kjo ndikon në implementimin e ligjit
2. Mungesa e infrastrukturës ligjore (ligji i tokës ndërtimore dhe ligji mbi shpronësim) si dhe akteve nënligjore të cilat e përcjellin Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor pengon në hartimin e planeve hapësinore komunale
3. Mungesa e Planit Hapësinor të Kosovës është pengesa më e madhe në përpilimin e planeve hapësinore komunale.
4. Kooperimi dhe Koordinimi i komunave dhe Institutit për planifikim hapësinor (në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor) të jetë në nivel të duhur
5. Komunitet zotohen se do të mundohen të gjejnë burime alternative për hartimin e planeve hapësinore komunale
6. Kërkohet shtyrja e afatit e cila është e caktuar me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor ku kërkohet që komunat të përpilojnë planin hapësinor komunal brenda afatit 18 muajor (ky afat skadon në fund të muajit Mars 2005)
7. Kërkohet nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor që të bëjë prezantimin e Ekstraktit të Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Nëse nuk është gati atëherë t'ju jepet një sugjerim



komunave në vija të trasha se si do të duket Plani hapësinor i Kosovës në mënyrë që komunat të kenë një vizion të qartë për të ardhmen

8. Gjatë Planifikimit Hapësinor të Kosovës të merren parasysh specifikat e ndryshme të Komunave (p.sh rasti i Komunës së Obiliqit me termodentrale dhe shfrytëzimin e pronës për shfrytëzimin e thëngjillit)
9. Prona e cila menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit shkakton probleme për përpilimin e planit hapësinor komunal
10. Kërkohen trajnime profesionale në "Përpilimin e detyrave Projektuese"
11. Komunat duhet të gjejnë forma për stimulimin e materialit për bartësit e proceseve (nëpunësit zyrtar që punojnë në drejtorinë e Urbanizimit)
12. Ndarja e buxhetit komunal për drejtorinë e Urbanizimit (vibron nga 2-10 % nëpër komuna). Drejtoritë komunale nuk mund të jenë efektive nëse nuk kanë buxhet me të cilin mund të punojnë pa pengesa.
13. Me rastin e re-bilancit të gjenden forma që kjo drejtori të përfitojë mjete materiale.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti I, Nr. 8 - Janar & Shkurt 2005

Bordi Botues: Sazan Ibrahim, Arsim Osmani, Mexhit Shaqiri, Merita Krasniqi

Rr. Isa Kastrati, Nr.113 Tel&Fax: 038 / 245 - 734
www.komunat-ks.net info@komunat-ks.net

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbështetet nga Agjencioni Evropian për Rindërtim përmes projektit "Përkrahje decentralizimit në nivelin komunal", implementuar nga IFES Ltd.



Statusin e Vëzhguesit



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština



Anëtar i përhershëm